





VLORË
ORTOFOTO E PËRFTUAR NGA IMAZHET SATELITORE

Përdorimi i shërbimeve satelitore për evidentimin e dëmeve nga zjarri

Në mbështetje të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC), ekspertë pranë ASIG nga Drejtoria e Përpunimit të të Dhënave Remote Sensing, kanë kryer analizimin e ndryshimeve të ndodhura në ngjarjen e fatkeqësisë natyrore nga zjarri i cili preku zonën e Shëngjinit. Me anë të përdorimit të teknologjisë së avancuar, u ndërtua harta e zonës së prekur nga zjarri duke shtuar elemente të cilët janë të rëndësishëm për:

- Vlerësimin, monitorimin dhe menaxhimin e riskut nga zjarri;
- Marrjen e masave strukturore për zvogëlimin e riskut;
- Vlerësimin e dëmit nga zjarri.



Publikimi në Gjeoportalin Kombëtar i paraqitjes 3D të ndërtesave për zonat urbane të disa qyteteve

ASIG, në kuadër të projektit për zgjerimin e hartës bazë topografike 1:2000, ka publikuar në Gjeoportalin Kombëtar paraqitjen 3D të ndërtesave për zonat urbane të qyteteve Belsh, Përmet, Rogozhinë, Prenjas, Peqin dhe Divjakë (fotografim i vitit 2015).

Me realizimin e paraqitjes 3D, ASIG ju vjen në ndihmë të gjithë të interesuarve për të eksploruar qytetet tashmë edhe në lartësinë e tyre, si nga ana vizuale ashtu edhe për llogaritje e aplikime të ndryshme.



Qyteti Përmet



Qyteti Prenjas

Realizimi i fotografimit 360° të gjeoreferencuar, të rrjetit rrugor kombëtar



Koman 2024




Pukë 2024

Me qëllim krijimin e fotografive panoramike të gjeoreferencuara të akseve rrugore kombëtare me teknologjinë e avancuar me kamera Street View 360°, ASIG ka realizuar fotografimin dhe publikimin në Gjeoportalin Kombëtar të aksit rrugor “Kosmaç - Koman - Pukë - Fushë-Arrëz - Iballë - Blinisht”, me një gjatësi të mbuluar me fotografi 360° prej 177 km.


Zgjerimi i Hartës Bazë - Qyteti i Belshit

ASIG në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës për temën “Imazhi i hartës bazë”, si dhe në kuadër të zgjerimit të projektit fillestar të Hartës Bazë të shkallës 1:2000, ka vijuar me krijimin e hartës topografike digjitale të qytetit të Belshit. Krijimi i kësaj harte është realizuar me anë të teknologjisë së rilevimit fotogrametrik 3D, duke mbuluar një sipërfaqe të rilevuar prej 5.7 km². Numri i shtresave të përdorura për këto rilevime fotogrametrike 3D arrin në 180.



Publikimi në ArcGIS Online i Mbulesës së Tokës - Bashkia Has

ASIG ka publikuar në ArcGIS Online WebMap-in me shtresën e Mbulesës së Tokës për Bashkinë e Hasit, i cili shërben për planifikimin urban dhe zhvillimin e Bashkisë Has, si dhe ofron një pamje të detajuar të strukturës së mbulimit të tokës. ASIG po vijon me krijimin e hartës tematike "Mbulesa e Tokës" për të gjitha Njësitë e Qeverisjes Vendore të territorit të Republikës së Shqipërisë.



BOTA E GJEOINFORMACIONIT

Esri nxjerr në treg publikimin e ri për dizenjimin e hartave 3D

Esri, lideri i tregut global të softuerëve të sistemeve GIS, inteligjencës së vendndodhjes dhe të hartave, njoftoi botimin e librit të ri "Mapping with Altitude: Designing 3D Maps". Ky libër është konceptuar që të jetë lehtësisht i kuptueshëm nga të gjithë përdoruesit e sistemeve GIS dhe është shkruar në një stil entuziast ndërsa eksploron konceptet, sfidat dhe mundësitë që paraqet hartografia 3D.

Mosaic dhe ESRI shpallin partneritetin strategjik

Kompania Mosaic ka krijuar një partneritet strategjik me Esri-n, i cili synon të përmirësojë platformën ArcGIS të Esri me teknologjinë e avancuar të imazheve 360°. Mosaic është një ofruer kryesor i pajisjeve të imazheve tokësore të nivelit të lartë, ndërsa Esri është lider global i softuerëve të sistemeve GIS. Partneriteti i Mosaic me Esri sjell imazhet 360° të vizualizimit të të dhënave gjeohapësinore brenda platformës ArcGIS, duke përmirësuar veçanërisht mjetet e vizualizimit të "Oriented Imagery".

AKTIVITETE NË VIJIM

INTERGEO 2024

Shoqëria për Gjeodezinë, Gjeoinformacionin dhe Menaxhimin e Tokës në Gjermani (DVW GmbH), organizon në Shtuttgart, konferencën INTERGEO 2024. Ky aktivitet synon të ofrojë një perspektivë globale dhe të lehtësojë bashkëpunimin ndërkufitar, duke shfrytëzuar potencialin e teknologjive të gjeoinformacionit dhe të koordinojë një përgjigje kolektive ndaj sfidave globale.

24-26 Shtator 2024

www.asig.gov.al

Smarter Data, Smarter World, on Tour 2024

Kompania "1Spatial" organizon në Birmingham, të Mbretërisë së Bashkuar, konferencën "Smarter Data, Smarter World on Tour 2024". Ky aktivitet mbledh profesionistë të industrisë së gjeoinformacionit nga e gjithë bota dhe ka në fokus Menaxhimin e Informacionit Gjeohapësinor (GeoIM) për infrastrukturën dhe sektorin e shërbimeve.

9 Tetor 2024

31st Workshop on Space Technology for Socio-Economic Benefits

Kombet e Bashkuara dhe Federata Ndërkombëtare Astronautike (IAF) organizojnë në Milano të Italisë, Workshopin mbi Teknologjinë Hapësinore për Përfitimet Social-Ekonomike. Qëllimi i aktivitetit është të mbledhë ekspertë nga sektori publik, privat dhe ai akademik për rritjen e ndërgjegjësimit mbi ndikimin e aktiviteteve hapësinore në mjedisin e Tokës.

11-13 Tetor 2024

www.geoportal.asig.gov.al